

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER ÇETINA HOXHAJ



V2023054500162055686

DATE 22/09/2023

NR REP 5151



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, para meje Notere ÇETINA HOXHAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Kamez, Rruga "Dubai", Kamëz, Godinë 4-Katëshe, Kati i Parë, Përballë me Qëndrën e Biznesit, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES:** *Tomorr Kotarja*, atësia Mifail, amësia Elemshahe, shtetas Shqiptar, lindur në Pralisht, Kukës dhe banues në Kamëz, me adresë Rr.'nënë Tereza'; Nd. 29/1; Kamëz; Laknas; 1030; Kamëz, lindur më 04/08/1977, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033853277 dhe nr. personal H70804063J.


**NËNSHKRUES:** *Shkumbin Kotarja*, atësia Mifail, amësia Elemshahe, shtetas Shqiptar, lindur në Pralisht, Kukës dhe banues në KAMËZ, me adresë Golaj 03840169; Nd. 9; H. 1; Kamëz; Bathore; 1054; Kamëz, lindur më 27/02/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037246056 dhe nr. personal I00227125C.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Statut" dhe "Akt-Themelimi" për rregjistrimin e shoqërisë "WHITE POWER CONSTRUACION" sh.p.k, bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërra "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrissë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

ÇETINA HOXHAJ



**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“WHITE POWER CONSTRUCTION”SHPK**

Në Kamez, sot më datë 22.09.2023

z.Tomorr **Kotarja** atesia Mifail amesia Elemshahe i lindur me 04/08/1977 ne Pralish, Kukes dhe banues ne Kamez, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar mbajtes i leternjoftimi me nr personal H70804063J .

z.Shkumbin **Kotarja** atesia Mifail amesia Elemshahe i lindur me 27.02.1980 ne Pralish, Kukes dhe banues ne Kamez me shtetesi Shqiptare, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtes i letrnjoftimit me nr.I00227125C ne cilesine e ortakeve me vullnet të lire, të plete e të sinqertë dhe iniciativën e lire private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës se Shqipëri, Kodin Civil në fuqi, në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, në Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, vendosen krijimin dhe regjistrimin e shoqërise “WHITE POWER CONSTRUCTION”SHPK

me të dhënat e mëposhtme:

**KREU I**

**Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti**

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është: “**WHITE POWER CONSTRUCTION**”  
**SHPK**

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria: “**WHITE POWER CONSTRUCTION**”shpk, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”), e themeluar nga personat fizikë të sipërpërmendor, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gjëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Rruga Donald Tramp ,pallati Shirzana ,pasuria me nr.74/119-N7,Kamez,Tirane kodi postar 1030. Shoqëria mund të ndryshoje selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërise, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti

Shoqëria do të ketë objekt të veprimtarisë:

**Objekti i veprimtarisë se shoqërisë**

1) *Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:*

a) Aktivitet në fushën e ndërtimit, si:

1 | F a q e

- i. *Punime germimi ne toke,*
- ii. *Ndertime civile dhe industriale,*
- iii. *-Rikonstruksion e mirembajtje godina civile,industriale.*
- iv. *-Rruge, autostrada, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportual.*
- v. *-Ujsjellsa, gazsjellsa,vajsjellsa, vepra kullimi e vaditje.*
- vi. *-Punime per prishjen e ndertimeve,*
- vii. *-Punime te germimit dhe tansportit te dheut dhe inerteve*
- viii. *-Punime murature, suva, armaturave, hekuri, duralumini*
- ix. *-Impianti hidro-sanitare,kuzhina, lavanteri,mirmbajtja e tyre,*
- x. *-Punime te rifinitures dhe te lidhura me to,*
- xi. *-Punime te rifinitures me materiale druri, plastik, metalik, xhami,*
- xii. *-Punime rifiniture te natyres teknike ndertuese,*
- xiii. *-Sinjalistike rrugore jo ndricuese.*
- xiv. *- Studimi, Projektimi i objekteve te ndertimeve industriale e civile.*
- xv. *- Mbikqyrja e punimeve te ndertimit .*
- xvi. *- Kolaudim te punimeve ne ndertim.*

b) Import - Eksport dhe tregtimi me shumicë e pakicë i materialeve te ndertimit, paisjeve te ndryshme, artikuj te ndryshem industriale, makineri e paisje, transport per vete dhe per te tretet.

2) Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi tregetimi, sherbimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike e juridike vendas dhe te huaj.

3) Shoqeria mund te ushtroje cdo veprimatri tjeter tregetare dhe prodhuese e cila nuk ndalohet me ligji. (Neni 7 i Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare").

Për kryerjen e aktiviteteve të shoqërisë së mësipërme për të cilin do të nevojitet leje përkatëse, shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këtë leje nga organi kompetent.

Neni 5  
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

**KREU II**  
**KAPITALI**

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (një qind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 2 kuota dhe vlera nominale e një kuote është 50 000 (pesedhjete mijë) lekë dhe perkatesisht:

**Tomorr Kotarja** zoterues i 1(nje)kuote me 50% e vleres se kapitalit themeltar

**Shkumbin Kotarja** zoterues i 1(nje)kuote me 50% e vleres se kapitalit themeltar  
Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.  
Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.(pa noter)

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qëndren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 8  
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

**Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.**

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e te pakten  $\frac{3}{4}$  tri të katërtave të zoteruesve te kapitalit te shoqerise, qe jane pjesmarres ne mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 10

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator. Kohëzgjatja e mandatit te Administratorit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ri-emërimi. Administrator i shoqërisë "WHITE POWER CONSTRUCTION"SHPK zgjidhet z. **Tomorr Kotarja** atesia Mifail amesia Elemshahe i lindur me 04/08/1977 ne Pralish, Kukes dhe banues ne Kamez, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar mbajtes i leternjoftimi me nr personal H70804063J.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqerinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpëra asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojë përpëra asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe ne rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpëra të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetete shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12  
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qëndren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

Neni 13  
Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emrëtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Neni 14  
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e statutit, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16

Dispozita përfundimtar

Ky akt themelimi u redaktua në 5 ekzemplare me përbajtje dhe vlera të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen pér nen nga Ortaket themelues te shoqërisë tregtare "WHITE POWER CONSTRUCTION"SHPK dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKET THEMELUES

Tomorr Kotarja



Shkumbin Kotarja

